



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 559/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rada Trajkovic nga subjekti politik Jedinstvena Srpska Lista (JSL) me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Branislav Nikolic, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 17.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHEN si të bazuara ankesat me nr. A559 dhe 560 të subjektit politik Jedinstvena Srpska Lista (JSL).

Srpska Liberalna Stranka (SLS), i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 3000 (tremijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik JSL, ne te cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, Kryetari i Komunës së Shtërpçës Branislav Nikolic së bashku me truporjat e tij kanë rrahur vëzhguesin Ljubic Marijan i cili ka qenë ne vend votim dhe nje kohesisht i ka kercenuar dhe maltretuar te tjeret tee cilet nuk kan qen pjes e partis se ti . Policia ka dal ne vend te ngjarjes dhe per keto ekziston procesverbali i policis.

Ne komunën e Graçanices ne rrugë para vendvotimit, pronari i lokalit në të cilin eshte vendosur komuna, ka shpërndarë paratë votuesve potencial dhe per këto ekziston video ingjizimi dhe ingjizimi me zë, procesverbali i policis lidhur me automjetin ne bagazhin e te cilit jan gjetur flet votime te plotësuar dhe nje shum e te hollave.

Ne vend votimin ne fshatin Gushteric e Poshtme ekziston nje numer i madh i shkeljeve te rregullave zgjedhore. Ne këtë kontekst, ne vendvotimet nr.3405e/01,02,03,04,dhe 05 ka ardhur deri tek sulmet brutale nga ana e simpatizantëve te SLS-së te cilet i kanë nxjerr jasht antaret e KVV-së dhe kjo ka

ndodh ne ora 08.15 dhe ne kete rast eshte dashur policia te intervenoj dhe pas intervenimit ky vendvotim eshte mbyll. Pas kësaj eshte pritur deri ne ora 23:00 per ekipin e KQZ-së te vi dhe te numëroj votat. Askush nuk ka evidencë për atë çfarë ka ndodhur në këtë interval kohor prej ores 08.15 deri ora 23.00.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratat e dëshmitarëve si provë, që kanë shërbyer si dëshmi për rastin në fjalë.

Në raportin e policisë nga koordinatori Baki Kelani, të datës 16.12.2010, të cilin PZAP-i e ka pranuar me 17.12.2010 në ora 08:44, na njoftoi se stacioni policor Graqanicë ka pranuar informatën se në afërsi të komunës të Graqanicës, saktësisht në lagjen e romëve, nga një veturë janë shpërndarë fletëvotime. Njësitë patrollues ka shkuar në vendin e gjarjes dhe ka gjetur veturën në fjalë, por në veturë nuk ishte askush, ndërsa në lokalin para të cilit ka qenë e parkuar vetura, kanë qëndruar disa persona. Zyrtarët policor kanë bërë kontrollimin e veturës dhe aty kanë gjetur 12 kopje të fletëvotimeve në të cilat është shënuar numri 39 i partisë SLS si dhe 5 numra të kandidatëve të kësaj partie. Zyrtarët policor kanë konfiskuar një kopje të këtyre fletëvotimeve dhe rasti nuk është hapur. (Si dëshmi është bashkangjitur raporti i policit me nr. të identifikimit 7885 të shkruar me datë 12.12.2010).

Ndërsa saj i përket ankesës se nga një veturë janë shpërndarë paratë tek votuesit potencial, zyrtarët policor të caktuar në sigurimin e këtij vendvotimit si dhe zyrtarët policor të cilët kanë patrolluar rreth vendvotimit, nuk kanë hasur në persona të cilët kanë shpërndarë paratë votuesve potencial. (Është bashkangjitur raporti policor me nr. 08-AT-0246 të datës 16.12.2010)

Sanksionimi për shkeljet e parimeve të këtij Kodi

Neni 8 paragrafi 1 i Rregullës Zgjedhore nr. 11/2009, parasheh;

Shkelja e njërit nga këto nene të kodit të Sjelljes, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga PZAP-i.

118.4 Mund të apeloher vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

120.1 c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Duke vendosur për gjobën, PZAP-i ka marrë si rrethanë rënduese se shkelja ka të bëjë me veprimet e ndaluara të LZP-së dhe Kodit Penal të Kosovës. Prandaj nga arsyet e lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim më

dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 559/2010 më datën 17.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

